



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic Of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opstina Pristina - Municipality Of Prishtina

Në bazë të nenit 13,14 dhe 97 të Ligjit për Procedurën Administrative nr. 02/L-28 dt. 22.07.2008, Nenit 57, pika "c" të Statutit të Komunës së Prishtinës nr. 01-110-455 dt. 31.03.2008; Drejtoria e Urbanizmit, duke vendosur sipas detyrës zyrtare dhe Vendimit me ref.16-INSP-28-QV-P-40 dt.18.10.2016 të inspektoratit të MMPH-së, në procedurë administrative, nxjerrë këtë:

KONKLUZION

- I. Korrigjohen, Kushtet Ndërtimore nr.05-350-166264 dhe 05-350-166264/1 dt.26.08.2014, të lëshuara nga kjo Drejtori, në emër të pronarëve Muharrem Hondozi, Mahir Dautaj, Remzi Dautaj, Shekib Dautaj, Afrim Dautaj dhe Fadil Dautaj, me investitor "Konak" sh.p.k., për hartimin e dokumentacionit teknik për ndërtimin e ndërtesës shumëbanesore me afarizëm "D", në bllokun "B11", të Planit Rregullues "Kalabria", në parcelën kadastrale, nr.10095-0 të evidentuar në çertifikatën e njësisë kadastrale P-71914059-10095-0, ZK Prishtinë.
- Korrigjimi i gabimit ka të bëjë me:
- Kushtet Ndërtimore nr.05-350-166264 dhe 05-350-166264/1 dt.26.08.2014, për hartimin e dokumentacionit teknik për ndërtimin e ndërtesës shumbanesore me afarizëm "D", respektivisht pikën I dhe në arsyetim të këtyre Kushteve Ndërtimore, ku në vend të "objektit "D" në kompleksin "Prishtina Stars", tani e tutje duhet të jetë vetëm "ndërtesa "D" kurse në pikat III paragrafi 2, teksti në kllapa duhet të largohet, si dhe në pikën IV paragrafi 2, teksti në kllapa "që ndërlidhet me këtë kompleks" duhet të largohet,
- II. Ky Konkluzion është pjesë përbërse e Kushteve Ndërtimore nr.05-350-166264 dhe 05-350-166264/1 dt.26.08.2014 dhe i njëjti prodhon efekte juridike nga dita e lëshimit të tij.

A r s y e t i m

Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit të Vendimit me ref.16-INSP-28-QV-P-40 dt.18.10.2016 të inspektoratit të MMPH-së, në bazë të së cilës është kërkuar rishqyrtimi i Kushteve Ndërtimore nr.05-350-166264 dhe 05-350-166264/1 dt.26.08.2014 dhe Vendimit të lejes ndërtimore nr.05-351-112758 dt.23.02.2016, respektivisht rishqyrtimi i lejimit të qasjes nëpërmes kompleksit "Prishtina Stars", si dhe ankesës së disa banorëve të kompleksit "Prishtina Stars", sipas detyrës zyrtare, e korrigjon gabimin dhe ate, në Kushtet Ndërtimore nr.05-350-166264 dhe 05-350-166264/1 dt.26.08.2014, për hartimin e dokumentacionit teknik për ndërtimin e ndërtesës shumbanesore me afarizëm "D", respektivisht pikën I dhe në arsyetim, të këtyre Kushteve Ndërtimore, ku në vend të

“objektit “D” në kompleksin “Prishtina Stars” , tani e tutje duhet të jetë vetëm “ndërtesa “D” kurse në pikat III paragrafi 2, teksti në kllapa largohet, si dhe në pikën IV paragrafi 2, teksti në kllapa “që ndërlihet me këtë kompleks” largohet.

Drejtoria e Urbanizmit pas konstatimit se ky korrigjim është në harmoni me Planin Rregullues “Kalabria”, i miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës me nr.01-35-853 dt.22.11.2005, e njejta sipas detyrës zyrtare përmisohet – korigjohet në bazë të ligjit, me anë të këtij Konkluzioni.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Konkluzioni

UDHËZIM JURIDIK: Pala e pakënaqur me këtë Konkluzion, përmes kësaj Drejtorie me ankesë mund t'i drejtohet Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor, brenda afatit prej 30 ditësh duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtij Konkluzioni.

I dorëzohet: Pronarëve dhe investitorit, Inspektoratit të MMPH-së, Drejtorisë së Inspektionit, kësaj Drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në lëndën bazë nr.05-350-166264 dhe 05-350-166264/1 dt.11.07.2014.

DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS
05 NR. 350-166264 DHE 05-350-166264/1, DT.16.05.2017

Punoi:
IDA Sazan Raskova,



Kontrolloj:
IDA Nazife Krasniqi,

